



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1188/1 Prot.

Tiranë, më 06.11.2023

V E N D I M

Nr. 227 , Datë 06. 11. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 229 Regj, datë 26.10.2023, të paraqitur nga z. N.S kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër (në vijim DRSSH Shkodër), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesi N.S parashtron se, për shkak të mos plotësimit të vjetërsisë minimale në punë, nuk përfiton pension. Kjo situatë vjen si rezultat i mosnjohjes të disa viteve punë, pasi nuk ka bordero. Në sistemin komunist dihet që puna ka qenë e detyrueshme për të gjithë dhe kanë punuar të gjithë. Ato vite për të cilat ISSH nuk ka bordero duhet të merren si të mirqëna me ndryshimet ligjore në dijeninë e tij, në rastet kur nuk ka bordero vitet merren të mirqëna si vite pune.

Sipas ankuesit, ligji nr.169/2020 ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djekur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar, ku në nenin 2, thuhet: “ Njohja e periudhës së sigurimit për

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

efekt përfitimi në varësi të periudhës së deklaruar nga vetë personat kërkues, bëhet respektivisht me ditë, muaj ose vite të plota pune, vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar:

- a) nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;
- b) nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë;
- c) ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish kooperativa bujqësore.

Ankuesi pretendon se ky është një diskriminim për shkak të moshës, pasi ai duhet t'a përfitojë pensionin minimal dhe kërkon nga Komisioneri që t'i njihen vitet e punës dhe përfitimin e pensionit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesi N.S, është i datëlindjes 28.05.1958, lindur në Rragam dhe banues në Rragam, Gur i Zi, Shkodër. Ankuesi ka paraqitur një kërkesë *on-line* në datën 26.06.2023 “Për Caktim Pensioni Pleqërie”, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër (DRSSH Shkodër). Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkesë, në datën 04.07.2023, ankuesi ka marrë në rrugë elektronike (*on-line*) përgjigjen e DRSSH Shkodër. Sipas kësaj përgjigjeje, rezulton se, Dega e Përfitimeve pranë DRSSH Shkodër ka vendosur të refuzojë kërkesën e ankuesit për caktim

pensioneri pleqërie. Arsyeja e refuzimit të kërkesës është fakti se ankuesit nuk ka 15 vite sigurim, por vetëm 4 vite, 9 muaj e 14 ditë. Konform nenit 86/1 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” ankuesit i është komunikuar në këtë vendim se ka të drejtën e ankimimit pranë KRA Shkodër brenda 30 ditëve, nga data e marrjes dijeni. Nga aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesi nuk rezulton që ai të ketë depozituar ankim kundër këtij vendimi të Degës së Përfitimeve pranë DRSSH Shkodër.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar nga DRSSH Shkodër, për shkak të moshës, sepse nuk i janë njohur disa vite punë pasi nuk ka bordero. Ankuesi kërkon nga Komisioneri që t’i njihen vitet e punës dhe të përfitoj pension pleqërie.

Pasi shqyrtoi pretendimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë me fushën e sigurimeve shoqërore, e cila rregullohet në bazë të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (në vijim ligji nr.7703/1993).

Në nenin 31 “Pension pleqërie”, të ligjit nr.7703/1993, përcaktohet:

“1. Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji;”

Referuar përcaktimeve të bëra nga neni 92, i ligjit nr. nr.7703/1993, rezulton se, mosha e daljes në pension në vitin 2023, për burrat, është 65 vjeç.

Sa më sipër, rezulton se, për të përfituar pension pleqërie duhet që personi të ketë mbushur moshën 65 vjeç dhe të ketë të paktën 15 vite sigurim.

Ankuesi, i cili është i ditëlindjes 28.05.1958, në 28.05.2023, ka mbushur moshën 65 vjeç, që përkon me moshën e daljes në pension sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Sipas përgjigjes së Degës së Përfitimeve pranë DRSSH Shkodër, ankuesit i është refuzuar kërkesa për caktim pensioni pleqërie, pasi nuk ka të paktën 15 vite sigurim shoqëror.

Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se ditët e punës për vitet 1976 -1977, 1981-1985, 1987-1991, që ankuesi ka deklaruar pranë ish Kooperativës Bujqësore Gur i Zi, fshati Rragam, nuk kanë rezultuar ditë pune për këto vite. Sipas verifikimeve të kryera nga Dega e Arkivës pranë DRSSH Shkodër, nuk disponohen bordero për verifikime të mëtejshme. Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se përfundimisht ankuesi ka periudhë sigurimi 4 vite, 9 muaj e 14 ditë, duke mos plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga neni 32, pika 1, të ligjit nr.7703/1993, për të patur të paktën 15 vite sigurimi.

Ankuesi pretendon se, bazuar në ligjin nr.169/2020, vitet e punës të deklaruara prej tij pranë ish kooperativës bujqësore, në mungesë të borderove, duhet t’i njihen si periudhë sigurimi për efekt

përfitimi nga sigurimet shoqërore, për sa kohë që nuk provohet se nuk ka qenë duke vuajtur dënim me heqje lirie, nuk ka qenë përfitues nga pensioni i invaliditetit të plotë dhe ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore.

Ligji Nr. 169/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, ka si qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501 datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar.

Në nenin 2 “Periudha e sigurimit dhe kushtet e njohjes së saj për efekt përfitimi”, të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Njihet si periudha e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga moshja për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

2. Njohja e periudhës së sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore sipas paragrafit të parë të këtij neni, në varësi të periudhës së deklaruar nga vetë personat kërkues, bëhet respektivisht me ditë, muaj ose vite të plota pune vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar:

a) nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;

b) nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë;

c) ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore”

Ligji përcakton se, periudhat e sigurimit të njohura në ish-kooperativat bujqësore sipas nenit 2, kanë efekt për përfitime që nuk janë caktuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sipas nenit 6, të ligjit të sipërcituar, ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë listën e ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë.

Rezulton se, në bazë dhe për zbatim të autorizimit të mësipërm ligjor, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr. 432, datë 15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ka miratuar Rregulloren Nr.1, datë 28.09.2021 “Për procedurat e funksionimit të komisioneve dhe veprimet administrative për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, në zbatim të ligjit nr. 169/2020”. Objekt i kësaj Rregullore, janë vetëm kërkesat për njohje të periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish-kooperativat bujqësore sipas listës së miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë

15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”. Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë rregullat e funksionimit të komisioneve, procedurat e aplikimit, rregullat e administrimit të praktikave, procedurat e shqyrtimit dhe përpunimit të kërkesave/deklaratave, lidhur me njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020 dhe VKM nr. 432/2021 dhe evidentimin e tyre në vërtetimin përfundimtar të vjetërsisë në punë për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore.

Në rast se koha e pretenduar e punësimit në ish kooperativat bujqësore e pretenduar nga ankuesi, rezulton e përfshirë në një prej kooperativave bujqësore të përfshira në listën e miratuar nga VKM nr.432, datë 15.07.2021, atëherë ankuesi duhet t’i drejtohet DRSSH Shkodër me një kërkesë për njohjen e periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish kooperativat bujqësore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021. Formulari tip i kësaj kërkesë dhe të gjitha procedurat e aplikimit, përcaktohet dhe rregullohen nga Rregullorja Nr.1, datë 28.09.2021, miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH. Sipas Rregullores, kërkesa për njohjen e periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish kooperativat bujqësore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021, mund të paraqitet në çdo kohë dhe fillon vetëm në bazë të kërkesës së Përfituesit.

Nga aktet e administruara nuk rezulton që ankuesi t’i jetë drejtuar DRSSH Shkodër me një kërkesë për njohjen e periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish kooperativat bujqësore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021. Ankuesi i është drejtuar DRSSH Shkodër me kërkesën për “Caktim Pension Pleqërie”, kërkesë kjo e ndryshme nga rregullimi dhe objekti i ligjit nr.169/2020, që pretendohet nga ankuesi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj

presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përliqur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjisllacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në

mungesë të një shkak të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e DRSSH Shkodër, për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të moshës, të pretenduar si shkak diskriminues nga ankuesi.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Ankuesi nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat mund të prezumohet se sjellja e DRSSH Shkodër, bazohet apo ka si shkak, moshën, të cilën ankuesi e ka pretenduar si shkak diskriminues. Ankuesi ka parashtruar problematikën në lidhje me mosnjohjen së viteve të punës për shkak të mungesës së borderove në ish kooperativën bujqësore, ku ankuesi pretendon se ka punuar dhe ka identifikuar moshën, si shkakun e pretenduar të diskriminimit, por nuk ofron asnjë shpjegim se si faktet për diskriminimin e pretenduar prej tij kanë lidhje/ndërveprojnë me shkakun e moshës.

Komisioneri vlerëson se, në thelb të pretendimeve të tij ankuesi kërkon verëtetimin e një fakti juridik, atë të njohjes së ekzistencës së marrëdhënies së punës në periudhën kohore të pretenduar prej tij, pra njohjen e vjetërsisë në punë, me qëllim përfitimin e pensionit të pleqërisë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni shqyrtimi i pretendimeve që ankuesi ka ngritur për njohjen e vjetërsisë në punë, për sa kohë që ato nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Në bazë të nenit 86, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet:

“Neni 86

Ankimimi

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar;

4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisionit të Ankimit pranë Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.”

Në nenin neni 32, të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet:

“Padia mund të ngrihet:

a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;

b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte;

c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.”

Sa më sipër, Komisioneri rekomandon ankuesin që për kundërshtimet e tij në lidhje me vendimarrjen e strukturave të sigurimeve shoqërore apo kërkesën për njohjen e vjetërsisë në punës, t’i drejtohet Gjykatës, si institucioni përgjegjës për të marrë në shqyrtim pretendime të kësaj natyre.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon ankuesit, që, për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike³, ose Shërbimit Ligjor Falas⁴.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi N.S kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe

³ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi “Zogu i Parë”, Tiranë.

⁴ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Tel: 0422 53113.

për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga ankuesi N.S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Moshë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim